



Ministria e Arsimit, Shkences, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEKNOLOGJIE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njesia Org.		Nr. Prot.	
Org. Juridicia	01	Broj Prot.	1218
Org. Unit.		Prot. No.	
Nr. faqeve		Data:	
Br. stranica	3	Datum	03.06.20
No. pages		Date:	



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Prishtinë, ___/___/2020
Nr. _____

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 05/2020 dhe shtojcës 4 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (20.02.2020), Udhëzimi Administrativ nr. 14/2017 për ndarjen e bursave, Vendimi nr. 41/01B, datë 22.05.2020 dhe duke marrë parasysh rrethanat e shkaktuara nga pandemia COVID -19 lidhë:

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Palët nënshkruese

1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, e përfaqësuar nga Ministrija e MASHTI, Znj. Hykmete Bajrami (në tekstin e mëtejshëm MASHTI), dhe
2. Universiteti Publik i Gjiilanit "Kadri Zeka", i përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi (në tekstin e mëtejshëm UKZ).

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është lehtësimi i procedurave të aplikimit të studentëve për bursat që ndahen nga MASHTI për Institucionet Publike të Arsimit të Lartë (më tej "IAL") për vitin akademik 2019/2020, si pasojë e rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19.

Neni 2 Të drejtat dhe detyrimet e MASHTI

1. MASHTI i zoton mjetet për përfituesit e bursave për studentët e Institucioneve Publike të AL.

2. Pas finalizimit të listave të studentëve përfitues, MASHTI bën ekzekutimin e pagesave në xhirollogaritë e përfituesve.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e UKZ

1. UKZ është e obliguar që të publikoj konkursin në platformën SMU dhe të ofrojë të gjithë mbështetjen teknike për aplikim të studentëve të tyre.
2. UKZ kryen procesin e pranimit të aplikacioneve të studentëve sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në konkursin e shpallur nga MASHTI.
3. UKZ cakton një person kontaktues i/e cili/a raporton në baza të rregullta tek Departamenti i Arsimit të Lartë në MASHTI.
4. UKZ pas përfundimit të afatit të aplikimit, e kompletton listën e kandidatëve të cilët kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit dhe të njëjtën e përcjell në MASHTI së bashku me të dhënat e xhirollogarive bankare.
5. UKZ është përgjegjëse për saktësinë dhe vërtetësinë e listës më të dhëna të studentëve të cilat i kanë plotësuar kriteret e konkursit
6. UKZ është e obliguar të njoftojë MASHTI-in për rrjedhat e realizimit të procesit të aplikimit të studentëve deri në përfundim të konkursit.

Neni 5

Kushtet dhe kriteret e nevojshme për aplikim

1. Për fitimin e bursës së MASHTI-t, kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte dhe kriteret bazë:
 - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Të kenë përfunduar së paku vitin e parë në studimet BA dhe vitin e parë për studimet MA;
 - 1.3. Të kenë të përfunduar vitet akademike paraprake, pa përsëritje të vitit;
 - 1.4. Të drejtë aplikimi kanë studentët e të gjitha fushave të studimit;
 - 1.5. Të drejtë aplikimi kanë studentët që kanë notën mesatare të studimeve së paku 9.0 të likuiduar deri në afatin e provimeve të shtatorit të vitit 2019.

2. Universitetet Pubkik obligohet që në listën përfundimtare të studentëve të përfshijë vetëm studentët të cilët plotësojnë kushtet e parapara me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 6

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak me shkrim të Ministres të MASHTI dhe Rektorit të UKZ-së marrëveshja mund të ndryshohet dhe të plotësohet.
2. MASHTI rezervon të drejtën e ndërprerjes së kësaj marrëveshje në rast se konstaton se UKZ nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 7

Zgjidhja e marrëveshjes

Palët janë pajtuar në mes veti që kjo marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 8

Numri i kopjeve

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy kopje, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptim të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Znj. Hykmete BAJRAMI



Ministre e MASHTI

02.06.2020

Prof. Asoc. Dr. Bajram KOSUMI



Rektor i UKZ

Universiteti Publik "KADRI ZEKU" Public University			
Pranuar nga data:		03.06.2020	
Numri i Dokumentit:	Numri:	Shifra:	Titulli:
	011	564	